

Operacionet

03/11/2026

Tiranë – Lëvizte I Armatosur Me Pistoletë Me Municion Luftarak, Arrestohet Në Flagrancë 20-Vjeçari

Procedohen penalisht 2 familjarët e 20-vjeçarit, pasi kundërshtuan punonjësit e Policisë gjatë kontrollit të banesës.

Sekuestrohen në cilësinë e provës materiale një armë zjarri pistoletë dhe municion.

Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Nr. 3, bazuar në informacionet e siguruara, në rrugën "Kastriotët" kanë ndaluar për kontroll automjetin me të cilin udhëtonte shtetasi S. D, 20 vjeç, banues në Tiranë.

Gjatë kontrollit të automjetit, shërbimet e Policisë kanë gjetur dhe sekuestruar një armë zjarri pistoletë dhe municion luftarak.

Në vijim të veprimeve hetimore, u arrestua në flagrancë shtetasi S. D., 20 vjeç, banues në Tiranë.

Ndërkohë, shtetasit A. D, 51 vjeç, dhe L. D, 23 vjeç, (familjarë të 20-vjeçarit), u proceduan në gjendje të lirë, pasi gjatë kontrollit të banesës kanë kundërshtuar punonjësit e Policisë për të penguar kryerjen e kontrollit.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Tiranë - Lëvizte i armatosur me pistoletë me municion luftarak, arr
Policia e Shtetit

Watch on

Nderim për një karrierë të ndërtuar me dinjitet dhe përkushtim!

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent

Copyright © 2026 Policia e Shtetit. All rights reserved. Theme: ColorNews by ThemeGrill. Powered by WordPress.